Inagurimi i hidrocentralit të Dardhës
5 qershor 2012

Fjalimi i Ambasadores

Zoti Deputet,
Zoti Kryetar i Këshillit rajonal,
Zoti Prefekt,
Zotërinj Kryetarë të bashkive,
Zoti President-Drejtor i Përgjithshëm i Compagnie Nationale du Rhône,
Zoti Drejtor i Përgjithshëm i Compagnie Nationale du Rhône,
Zoti President i Shoqërisë Ylliad,
Zoti Drejtor i Përgjithshëm i Wenerg,
Zonja dhe Zotërinj,

Sot marr pjesë me shumë kënaqësi së bashku me ju dhe në këtë mjedis kaq të mrekullueshëm, në këtë shoqëri kaq të nderuar, në inagurimin e centralit për prodhimin e energjisë elektrike të Dardhës.

Kjo vepër meriton të përshëndetet në shumë aspekte.

Së pari, kemi të bëjmë me një partneritet të vërtetë ku përveç Compagnie Nationale du Rhône, kanë kontribuar disa shoqëri franceze, franko-shqiptare dhe shqiptare, pa harruar autoritetet Shqiptare dhe popullatën vendore. Do të doja të përshëndesja në veçanti shoqërinë WENERG, shoqërinë YLLIAD dhe Z. Julien Roche, guri i themelit i të gjitha arritjeve, për të cilat jemi mbledhur sot.

Së dyti, ky investim do të kontribojë për një kohë shumë të gjatë në favor të popullatës dhe në rritjen e aftësive prodhuese të ekonomisë shqiptare.

Së treti, ky projekt është konkretizimi i prioritetit të qeverisë shqiptare për prodhimin e energjisë së rinovueshme, kryesisht me anë të ujit, një nga pasuritë natyrore, shfrytëzimi i së cilës duhet zgjerohet sa më shumë.

Me këtë zgjedhje, Shqipëria është në të njëjtën gjatësi vale me problemet e zhvillimit të qendrueshëm, të cilat përbëjnë një sfidë themelore në shkallë botërore. Kjo temë është shumë aktuale dy javë para Konferencës së Rios +20. Franca është shumë e angazhuar në këtë rrugë, në veçanti në shfrytëzimin e qendrueshëm të ujit. Si Seli e Këshillit Botëror të Ujit (në Marsejë), ajo organizoi në mars Forumin e Gjashtë Botëror të Ujit. Ajo ka specialistët më të mirë, siç janë ata të Zyrës Ndërkombëtare të Ujit, një organizatë profesionale franceze, të cilët janë vënë në dispozicion të Shqipërisë për të ndihmuar në hartimin e normave teknike për t'iu përgjigjur si nevojave të saj ashtu edhe kritereve evropiane.

Sigurisht që Franca llogarit edhe shumë ndërmarrje ose grupe ndërmarrjesh me ekspertizë të gjerë në fushën e ujit dhe të energjisë së rinovueshme. Midis tyre futet CNR-ja, prodhuesi i parë francez i energjisë së rinovueshme, specialiste e shquar e hidroenergjisë. Ndihem e kënaqur që, falë ndërtimit të këtij centrali, objekt i një koncesioni, CNR-ja

angazhohet vazhdimisht në Shqipëri dhe shpresoj se ky partneritet do të gjejë zgjerime në realizimin e projekteve të tjera, në lidhje me hidroenergjinë ose me forma të tjera të energjisë së rinovueshme.

Me ardhjen e CRN-së ka filluar një etapë e re në bashkëpunimin ekonomik franko-shqiptar, i cili ka njohur një rritje të vazhdueshme vitet e fundit. Ne jemi në drejtimin e duhur dhe kjo është bërë e mundur në sajë të një njohjeje më të mirë, në Francë të potencialeve të Shqipërisë, njohje për të cilën kanë kontribuar jo vetëm shërbimet ekonomike të ambasadës, por edhe ndërmarrjet franceze që janë vendosur këtu si dhe Klubi i Biznesit franko-shqiptar krijuar së fundmi.

Edhe pse gjeografikisht vendet tona nuk janë afër njëri-tjetrit, ato kanë mes tyre, që prej shumë kohësh, një marrëdhënie të fortë, e cila shprehet në lidhjen e ngushtë me frankofoninë ashtu edhe në traditën e gjatë të shkëmbimeve mes universiteteve dhe shkollave të mëdha franceze dhe unë shoh këtu disa persona që mund të na e dëshmojnë personalisht. Këto lidhje njerëzore, ky komunitet me formim intelektual, janë pikat më të forta për të ardhmen e miqësisë franko-shqiptare. Shpresoj që ato të zhvillohen edhe më tej, ambasada do të japë kontributin e saj dhe unë gjithashtu kam besim te të gjithë ju.

Ndërkohë, vë re që qielli dërgon një sinjal të shkëlqyer për inagurimin e këtij centrali të vendosur nën shenjën e ujit, dhe i përcjell urimet e mia më të mira për suksese centralit të ri të Dardhës.